



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2457 Prot

Shkodër, më 14 . 07 .2025

V E N D I M

Nr. 206 ,datë 14 . 07 .2025

"PËR MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KIZ DHE KZF PËR PROCESIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME TË VITIT 2025 NË USH"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Rregullores "Për organizimim e zgjedhjeve të autoriteteve drejtuese dhe Senatin Akademik në USH", e ndryshuar; Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr.101, datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë"; Urdhrit të Rektorit nr.72, datë 04.06.2025 "Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datës së zgjedhjeve, për autoritetet drejtuese në njësitë bazë dhe njësitë kryesore që nuk kanë autoritet drejtues të zgjedhur", Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 14.07.2025,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit masën e shpërblimit të anëtarëve dhe sekretarit të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve si dhe Komisioneve Zgjedhore të Fakulteteve në: FE, FD, FSHN dhe FSHSH, për punën e kryer në procesin e zgjedhjeve të pjesshme të vitit 2025.
2. Shpërblimi të jetë në masën 50% të vlerës së akorduar sipas Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 271, datë 26.11.2024, për punën e kryer në zgjedhjet e përgjithshme në USH, për secilin komision të cituar në pikë 1, të këtij vendimi
3. Ky vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të USH-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Tonin GJURAJ